

DRAFT DEKLARATË E PËRBASHKËT

Në përmbyllje të takimit të dytë ndërparlamentar, të zhvilluar në mes të Parlamentit Evropian dhe Kuvendit të Kosovës, i cili u mbajt në Prishtinë, me 6 dhe 7 Prill 2009, Kryetarja e Delegacionit të Parlamentit Evropian, Doris Pack dhe Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi dhanë deklaratën në vijim.

Ne lidhje me situatën politike dhe hapat drejt integritet evropian

1. Shprehemi të kënaqur me zhvillimet e përgjithshme politike në Kosovë, një vit pas shpalljes së pavarësisë dhe miratimit të Kushtetutës, e cila për Kosovën shënon fillimin e periudhës sfiduese të shtet ndërtimit ku përfshihet edhe vendosja e marrëdhënieve diplomatike. Megjithatë, incidente të raportuara dhe ngjarjet tjera që në raste të caktuara e bëjnë situatën fragjile nuk duhet të nënvlerësohen.
2. Ritheksojmë se institucionet e Kosovës duhet të punojnë drejt marrjes së pronësisë ndaj përgjegjësisë politike dhe implementimit të standardeve për funksionimin e shoqërive multi etnike dhe demokratike evropiane. Kjo do të mundësojë Kosovës vet qëndrueshmëri dhe Integritet Evropian, por duke rikujtuar edhe njëherë që dispozitat Kushtetuese duhet të zbatohen me përpikëri.
3. Shprehim mbështetjen për planin e Qeverisë së Kosovës për fillimin e regjistrimit të popullsisë në prag të zgjedhjeve lokale që parashihet të mbahen gjatë vitit 2009. Në këtë drejtim ftojme autoritetet kosovare dhe institucionet ndërkombëtare të punojnë drejt sigurimit të pjesëmarrjes së gjerë të serbëve me qëllim që të evitohet një proces zgjedhor që shënon një eksperiencë të ndarjes dhe mospjesëmarrjes. Gjithashtu presim që caktimi i datës së zgjedhjeve të jetë konsistent me progresin e arritur në procesin e decentralizimit. Njëkohësisht të mendohet edhe për një proces demokratik që mundëson transferimin e lehtë të kompetencave në përfundim të mandatit të institucioneve aktuale
4. Theksuam edhe njëherë përkushtimin e Unionit Evropian në rolin e vet udhëheqës për të siguruar stabilitet në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimorë si tërësi. Nga BE-ja kërkohet vullneti për të ndihmuar në zhvillimin ekonomik dhe politik të Kosovës por edhe duke i ofruar perspektivën e qartë drejt anëtarësimit në BE. Në këtë drejtim duhet të ceket fakti se procesi i reformimit është fatkeqësisht i ngadalshëm dhe se Qeveria duhet të bëjë më shumë për të rritur nivelin e transparencës

5. Mirëpresim vendimin e Komisionit në lidhje me “Strategjitë e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2008-2009” i cili parasheh që në vjeshtën e vitit 2009 t të nisë studimi i fizibilitetit i cili do të vlerësojë mundësitë për zhvillimin e mëtutjeshëm ekonomik dhe politik të Kosovës dhe përcaktimin e formave me të cilat Kosova do të shënojë progres më të madh si pjesë e rajonit në rrugën drejt integritit në BE, e veçanërisht në kontekst të procesit të Stabilizim Asocimit.
6. Vëmendje e veçantë i është kushtuar raportit të fundit të Progresit të Komisionit Evropian i publikuar në muajin Nëntor 2009 i cili ka theksuar progresin e arritur në adresimin e disa prioritetëve të Partneritetit Evropian, rreth të drejtave civile dhe politike, miratimin e legjisllacionit për të drejtat kulturore dhe të minoriteteve dhe aspekte të tjera që ndërlidhen me kriteret politike dhe ekonomike për integrim në BE. Raporti po ashtu ka shpalosur edhe shqetësimet në lidhje me dobësitë dhe jo efikasitetin e administratës publike, gjyqësorit, pastaj zgjerimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar, duke kërkuar nga organet kompetente të luftojnë këto dukuri së bashku me institucionet ndërkombëtare në vend. Reformat në këto procese duhet të intensifikohen.
7. Rekomandojmë që çështjet që ndërlidhen me integrimin në BE duhet të diskutohen vazhdimisht dhe të adresohen përmes një koordinimi më të mirë në mes të Qeverisë dhe Parlamentit. Ky koordinim është me rëndësi veçanërisht në krijimin e kapaciteteve për mbikëqyren e zbatimit të ligjeve dhe ushtrimin e mbikëqyrjes efikase ndaj Qeverisë, por edhe intensifikimin e bashkëpunimit në mes të institucioneve shtetërore dhe shoqërisë civile. Ndërhyrjet politike në administratën publike dhe aferat korruptive nuk duhet të tolerohen. Ndërsa nga Qeveria dhe institucionet ndërkombëtare kërkohet që me vendosmëri të zbatojnë politikën e tyre anti korrupsion. Luftimi i krimin dhe korrupsionit është i domosdoshëm me qëllim që të fitohet besimi i qytetarëve andaj edhe duhet të mbështetet me të gjitha masat e nevojshme ligjore. Institucionet duhet të veprojnë në mënyrë transparente dhe fer në adresimin e këtyre çështjeve.
8. Kërkohet nga Komisioni Evropian dhe vendet anëtare të BE-së që të ndihmojnë Qeverinë e Kosovës në zgjedhjen e problemeve që kanë të bëjnë me mungesën e personelit të kualifikuar në sektorët kyç të administratës publike, duke ofruar programe trajnuese për shërbyesit civil dhe përmirësimin e infrastrukturës së komunikimit me qëllim që funksionimit sa më efikas të administratës.

Në lidhje me EULEX-in

9. Nga Qeveria e Kosovës dhe institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare të intensifikojnë veprimet e tyre në rritjen e shkallës së sundimit të ligjit dhe konkretizimin e luftës kundër korrupsionit me ndërmarrjen e masave specifike. Mirëpritet vendosja e EULEX-it në tërë territorin e Kosovës. Ftohen të gjithë shtetet e BE-së të qëndrojnë unike në mbështetjen e tyre për misionin e EULEX-it në tërë territorin e Kosovës ashtu siç qëndruan në momentin e lansimit të këtij misioni.
10. Shprehim shqetësimin për sfidat operacionale me të cilat po përballet EULEX në shtrirjen e tij, kryesisht të natyrës materiale, teknologjisë informative dhe resurseve njerëzore dhe ftojmë Këshillin e BE-së që të adresojë pengesat e observuara në këtë drejtim.

11. Presim nga EULEX të funksionojë ne përputhje me mandatin e dhënë nga BE duke u fokusuar veçanërisht në stabilitetin e zhvillimeve politike dhe garantimin e sundimit të ligjit për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë. Theksojmë po ashtu se EULEX u shërben edhe për mbrojtjen e interesave të minoriteteve etnike në Kosovë sidomos në adresimin e ankesave për diskriminim, ngacmim, dhunë, krime ndëretnike dhe çështje të kontesteve pronësore.
12. Mirëpresim pajtimin e Qeverisë së Serbisë me shtrirjen e EULEX-it dhe inkurajojmë Serbinë që të vazhdojnë të mbajë qëndrime konstruktive dhe të bashkëpunojë me këtë mision.
13. Ndajmë pikëpamjet se marrëdhëniet aktuale dhe ato në të ardhmen në mes të EULEX-it dhe UNMIK-ut i cili tashmë ka rol tjetër dhe perceptimeve të këtyre marrëdhënieve nga institucionet Kosovare, duhet të inspirohen nga pragmatizmi, shkëmbimi i hapur i përvojave dhe qëndrimit konstruktiv që shkon në dobi të të gjithë qytetarëve dhe të gjitha komuniteteve të Kosovës. Në këtë kontekst, me qëllim të unifikimit të Kosovës nën një sistem ligjor të vetëm, theksojmë deklaratën e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së se pas procesit të ri konfigurimit, UNMIKU do të mbajë një prezencë të vogël në terren, derisa një alternativë tjetër për të cilën pajtohen palët do të jetë në dispozicion, duke konsideruar se në këtë periudhë forcimi i rolit të OSBE-së në Kosovë mund të ndihmojë.

Rreth decentralizimit, komuniteteve dhe veriut

14. Shprehim pikëpamjet se autoritetet Kosovare duhet të vazhdojnë të implementojnë gradualisht decentralizimin dhe të definojnë e sqarojnë marrëdhëniet dhe kompetencat rreth ndarjeve buxhetore në mes të nivelit qendror dhe lokal, kompetencat që çështjet publike, transparencën dhe efikasitetin e autoriteteve në nivel lokal në raport me interesat e qytetarëve, përmirësimin e kushteve të jetesës duke qartësuar se decentralizimi nuk është vetëm në interes të komunitetit Serb por të gjithë qytetarëve të Kosovës.
15. Ritheksojmë se pajtimi i ndërsjellë, respektimi i të drejtave të gjitha komuniteteve dhe anëtarëve të tyre dhe ndërtimi i besimit të ndërsjellë duhet të jenë prioritete absolute. Liria e shprehjes, lira e lëvizjes, kthimi i qëndrueshëm, reformat e pushtetit lokal, ofrimi i shërbimeve esenciale për të gjitha komunitetet dhe në veçanti për minoritetet duhet të sigurohen. Pjesëmarrja e Serbëve të Kosovës dhe minoriteteve tjera në institucionet Kosovare dhe administratën publike gjithashtu është esenciale. Rezultat i këtij evoluimi duhet të jetë zhvlerësimi i strukturave paralele dhe zhbërja e tyre. Prezenca e BE-së në Kosovë është po ashtu garanton se të drejtat e komuniteteve minoritare do të respektohen plotësisht dhe se kushtet e jetës do të përmirësohen sidomos në kampet e romëve në veri të vendit, përderisa përgjegjësitë kryesore për përmbushjen e këtyre objektivave i takojnë institucioneve të Kosovë dhe shoqërisë civile. Në këtë kontekst vlerësohet pozitivisht dhe çmohet angazhimi personal i Kryeministrit të Kosovë në serinë e tryezave të rrumbullakëta dhe takimeve me përfaqësuesit e komuniteteve për të diskutuar rreth të drejtave kulturore, decentralizimit dhe çështjeve tjera praktike.

16. Theksojmë nevojën që autoritetet kosovare të përshpejtojnë përpjekjet e tyre drejt pajtimit dhe afrimit të komuniteteve minoritare si dhe zbatimin e dispozitave Kushtetuese që ndërlidhen me të drejtat e minoriteteve. Në anën tjetër shprehim keqardhje për mungesën e vullnetit të komunitetit Serb të Kosovës për të marrë pjesë në zbatimin e kornizës së re për qeverisje lokale të miratuar nga autoritetet Kosovare, gjë që po rezulton me vonesa në krijimin e komunave të reja me shumicë serbe dhe në procesin e decentralizimit të përgjithësi. Megjithatë, përshëndesim pjesëmarrjen e përfaqësuesve Serb në Kuvendin dhe Qeverinë e Kosovës dhe inkurajojmë ata dhe përfaqësuesit e komuniteteve tjera pakicë që të marrin pjesë në jetën politike, ekonomike dhe sociale dhe të vazhdojnë të punojnë drejt integritit të plotë në shoqërinë Kosovare.
17. Pranojmë kompleksitetin dhe ndjeshmërinë e situatës në Veriun e Kosovës, ku në mes tjerash autoritetet Kosovare nuk mund të ushtrojnë kompetencat në fushën e gjyqësisë dhe doganave dhe kërkojmë përkushtim të përbashkët dhe angazhim intensiv me qëllim që sa më shpejt të arrihet progres në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit duke siguruar kështu sundimin e ligjit në Veriun e Kosovës, me qëllim të normalizimit të marrëdhënieve fqinjësore.
18. Ftojme të gjitha palët, e në veçanti autoritetet lokale dhe përfaqësuesit e minoriteteve dhe Qeverisë që të angazhohen për zhvillimin e dialogut teknik në lidhje me mbrojtjen, konservimin, rehabilitimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe religjioze në Kosovë.

Në lidhje me arsimin, trajnimin dhe mirëqenies sociale

19. Inkurajojmë Qeverinë e Kosovës të ndjek një strategji më ambicioze në fushën e arsimit, duke u përqendruar fillimisht në fuqizimin e arsimit të obliguar, përmirësime substanciale në infrastrukturën fizike, furnizimin me materialet bazë, monitorimin e programeve shkollore dhe kurrikulimit, duke u fokusuar veçanërisht në komunitetet pakicë. Në këtë drejtim duhet siguruar edhe trajnime profesionale me qëllim të ndërtimit të kapaciteteve njerëzore që ndihmojnë zhvillimin e ekonomik të Kosovës dhe janë konkurrent në tregun evropian, por që njëkohësisht konsiderohet si mjeti më efikas në uljen e papunësisë në mesin e të rinjve. Gjithashtu mendojmë se përveç Universitetit të Prishtinës dhe atij të Mitrovicës, themelimi i një Universiteti Evropian multi-etnik në pjesën qendrore të Kosovës mund të jetë një projekt në partneritet me Komisionin Evropian i cili ia vlen të konsiderohen.
- 19 a) Presim nga Qeveria të angazhohet në përmirësimin e sistemit për asistencë sociale i cili është shumë i nevojshëm për disa nga shtresat e rrezikuara të shoqërisë, por që momentalisht po tregojnë mungesë të koordinimit, mungesë të fondeve dhe kapaciteteve administrative.

Rreth zhvillimit ekonomik

20. Ritheksojmë se Kosovarët duhet të jenë më të vëmendshëm ndaj domosdoshmërisë së marrjes në duart e tyre ekonominë e vendit, me qëllim që të arrihet një zhvillim i qëndrueshëm ekonomik, të sigurohen investime e punësim të cilat pastaj do të gjenerojnë stabilitet dhe qëndrueshmëri. Për këtë qëllim, Qeveria duhet që sa më shpejt të zhvillojë një strategji të detajuar për zhvillim ekonomik, duke i kushtuar vëmendje të veçantë sektorit të minierave, energjisë, bujqësisë, zhvillimit rural, zhvillimit të burimeve

potenciale që ndihmojnë rritjen ekonomike. Kjo duhet të shoqërohet me një politikë adekuate fiskale, politika për krijimin e vendeve të punës, promovimin e eksporteve si dhe përmirësimin e sistemit të arsimit dhe beneficioneve sociale. Duke marrë parasysh procesin e privatizimit, kërkohet nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit që veprojë në mënyrë transparente dhe në përputhje me dispozitat ndërkombëtare dhe ato të BE-së në lidhje me mbrojtjen e të drejtave pronësore, por njëkohësisht kërkohet zbatimi i legjislacionit përkatës i cili siguron mbrojtjen e të drejtave pronësore dhe kompensimin e dëmeve eventuale pronësore.

20 a) Ritheksojmë rëndësinë e funksionimit të mirëfilltë të sistemit për furnizim me energji si një parakusht për tërheqjen e investimeve, rritjen e inkasimit dhe mbledhjes së borxheve por njëkohësisht përshëndesim iniciativën e Qeverisë për tu përqendruar në promovimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë kur dihet se vlerësimet para përgatitore për studimin e fizibilitetit kanë konstatuar se ekziston potencial i konsiderueshëm për energji solare.

21. Mirëpresim përkushtimin e Komisionit për shfrytëzimin e instrumenteve të Komunitetit Evropian e veçanërisht IPA-në, me qëllim të përsheptimit të zhvillimit socio-ekonomik të Kosovës. Ndërsa nga Qeveria kërkohet që të shfrytëzojë donacionet publike dhe ndërkombëtare në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme. Nga Komisioni Evropian në anën tjetër kërkohet që të ndihmojë Kosovën të lëvizë më afër standardeve evropiane në fushën e përgjegjësisë në sektorin publik dhe transparencës ekonomike, si karakteristika esenciale për krijimin e një ambienti atraktiv për investime dhe zhvillim të bizneseve.

22. Jemi shumë të vendosur në domosdoshmërinë e vazhdimit dhe intensifikimit të marrëdhënieve të rregullta në mes të Parlamentit Evropian dhe Kosovës në vitet në vijim, të bindur se bashkëpunimi dhe dialogu ndër parlamentar, veçanërisht në mes të Parlamentit Evropian dhe Kuvendit të Kosovës, por edhe në mes të parlamenteve të rajonit, kanë rëndësi të veçantë në kudër të kornizës së Stabilizim Asocimit dhe proceseve drejt integritimit në BE.